

foto kopje

Njesia Jo Fitimprurese

NIPT -i

Adresa e Selise

INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABEL

K41605030L

Rr.Elbasanit-Tirane

Nr. i Vendimit te Gjykates

35

Data e Vendimit te Gjykates

16.10.1998

Veprimtaria Kryesore

ORGANIZIMI I PROFESIONIT TE AUDITUESIT LIGJOR

PASQYRAT FINANCIARE

(Organizatat Jo Fitimprurese)

(Ne zbatim te Standardit Kombetar te Kontabilitetit per OJF-te)

Viti 2021

Pasqyra Financiare jane te shprehura ne
Pasqyra Financiare jane te rumbullakosura ne

Leke

Periodha Kontabel e Pasqyrave Financiare

Nga

01.01.2021

Deri

31.12.2021

Data e mbylljes se Pasqyrave Financiare

20.07.2022



[Handwritten signature]



Pasqyrat e pozicionit Financiar për periudhën 1 Janar deri
me 31 Dhjetor 2021

	Shënimi nr.	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2021	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2020
AKTIVE			
Aktive Afatshkurtëra			
Mjete monetare	4	82,569,621	75,219,787
Llogari te arketueshme	5	10,303,848	6,900,663
Inventaret	6	354,576	354,576
Llogari te arketueshme te tjera (kuota variabel)	7	10,107,451	8,368,781
Shpenzime te periudhave te ardheshme	11		
Totali i Aktiveve Afatshkurtëra (I)		103,335,495	90,843,807
Aktive Afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	8	31,998,367	33,290,329
Aktivitet afatgjata jomateriale			
Totali i Aktiveve Afatgjata (II)		31,998,967	33,290,329
TOTALI I AKTIVEVE (I + II)		135,333,862	124,134,136
DETYRIMET DHE PASURIA NETO			
Detyrime			
Llogari te pagueshme	9	10,298,864	5,623,601
Detyrime te tjera (kuota variabel)	7	545,777	477,316
Detyrime tatimore	10	821,360	358,316
Te ardhura te periudhave te ardhme	11	526,070	586,070
Totali i Detyrimeve Afatshkurtëra (I)		12,191,890	7,045,303
Totali i Detyrimeve		12,191,890	7,045,303
AKTIVET NETO	12	123,141,972	117,088,833

1

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021
(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)



Pasqyra e burimeve të fondeve për vitin e mbyllur në 31 Dhjetor 2021

	Shënimi nr.	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2021	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2020
BURIMET E FONDEVE			
Burime nga veprimtarite kryesore	13	26,764,822	28,629,883
Kuotat e anëtarësimit të AL, shoqërive, kandidatëve		25,870,212	27,750,945
Të ardhura të tjera		894,610	878,938
Burimet nga kualifikimi i EKR & stazhierë	15	2,766,000	3,320,000
Burimet nga publikimet	16	-	3,400
Totali i burimeve - të ardhurave		29,530,822	31,953,283
PERDORIMET E FONDEVE			
Përdorimet për veprimtarinë kryesore	14	21,266,772	22,178,411
Pagat dhe sigurimet shoqërore të personelit		5,853,916	7,041,578
Honorare të Drejtimit, Autoritete, Komitete etj		5,284,000	5,279,500
Shpenzime administrative dhe të tjera		10,128,856	9,857,333
Shpenzime kualifikimi i EKR & stazhierëve	15	2,249,905	2,996,446
Shpenzime për botime	16	-	82,877
Totali i perdorimit të fondeve		23,516,677	25,257,734
Teprica e burimeve nga veprimtaria kryesore			
Humbje nga kursi i këmbimi		-6,006	5,110
Te ardhura nga interesat	13	45,000	295,733
Te ardhura (shpenzime) financiare		38,994	300,843
Aktivitet sipas vendimit të Asamblese			
Teprica/deficit i burimeve nga veprimtaria kryesore	17	6,053,139	6,996,392
Aktivitet neto në fillim të vitit		117,088,833	110,092,441
Aktivitet neto në fund të vitit		123,141,972	117,088,833

[Signature]
2022

[Signature]
2



Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021
(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare (cash flow) per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021

	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2021	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2020
Rrjedha e parase nga veprimtaritë e shfrytëzimit		
Perdorime te fondeve per vitin	6,053,139	6,996,392
Rregullime për:		
Amortizimin	1,291,962	1,446,138
Nxjerrje jashte perdorimit te AAM	-	-
Efekti i ndryshimit ne politiken kontabel	-	-
Rritje/rënie në aktivet afatshkurtera	5,141,854	1,976,744
Rritje/rënie në detyrimet afatshkurtera	5,146,587	2,309,043
Rrjedha e parase e përfituar nga aktivitetet e shfrytezimit	7,349,834	4,156,743
Rrjedha e parase nga veprimtaritë investuese		
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	-	644,106
Të ardhura nga shitja e pajisjeve	-	-
Rrjedha e parase e përdorur në aktivitetet investuese	-	644,106
Rrjedha neto e parase	7,349,834	3,512,637
Mjetet monetare në fillim të vitit (shenimi 4)	75,219,787	71,707,150
Mjetet monetare në fund të vitit (shenimi 4)	82,569,621	75,219,787

3



1. Informacion i përgjithshëm

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (më poshtë "IEKA" ose "Instituti"), është një shoqatë profesionale që grupon Audituesit Ligjorë dhe Shoqëritë Audituese që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë. IEKA është krijuar në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1, datë 2 tetor 1995 dhe është regjistruar me Vendimin e Gjykatës së rrethit Tiranë nr. 3573, datë 16 tetor 1998. Instituti ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me Ligjin nr.10091, datë 5 mars 2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar" (të ndryshuar), si dhe me Ligjin për "Organizatave jo-fitimprurëse" dhe me statutin e tij.

Veprimtaria kryesore e Institutit ka për qëllim të sigurojë që profesioni i Audituesit Ligjor vepron në përputhje me interesat e publikut si dhe të mbrojë etikën dhe pavarësinë e anëtarëve të tij. Veprimtaria e Institutit mbikëqyret nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike. Selia e Institutit ndodhet në "Rruga e Elbasanit", pallati Edil AI - IT, zyra 321, Tiranë, Shqipëri.

2. Baza e përgatitjes

(a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në politikat kontabël të përshtatura nga Këshilli Drejtues dhe Asambleja e Përgjithshme për qëllime të raportimit të IEKA si dhe në përputhje me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit të Organizatave Jo-fitimprurëse (SKK për OJF) në fuqi nga 1 Janar 2016.

Politikat kontabël si më poshtë paraqesin të plotë bazën e përgatitjes së pasqyrave financiare.

(b) Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

(c) Ndryshim i politikës kontabile për njohjen e të ardhurave nga kuota variabile

Mbështetur në vendimin nr. 14, datë 28 dhjetor 2012 të Këshillit Drejtues, në 1 janar 2013 Instituti ndryshoi politikën e njohjes së të ardhurave për kuotën variabël. Sipas këtij vendimi shumat e të drejtave/detyrimeve lidhur me deklaratimet dhe pagesat e kuotës variabël të AL të azhuruara deri më 31 Dhjetor 2015 janë përfshirë në llogaritë përkatëse të AL-ve dhe shoqërive të auditimit.

Në përputhje me politikën e re kontabël të ardhurat nga kuota variabël do të njihen në momentin e deklaratimit të kuotës variabël në shumat e përlllogaritura bazuar në tabelat e misionëve të deklaruara prej AL-ve dhe shoqërive të auditimit dhe pagesat e kryera gjatë vitit do të ulin detyrimin për kuotën variabël të deklaruar e të papaguar.

(d) Vijueshmëria

Pasqyrat financiare janë përgatitur sipas parimit të vijueshmërisë. Sipas këtij parimi, IEKA parashikon se veprimtaria e saj do të ketë vijimësi në mënyrë të mjaftueshme që të plotësojë objektivat dhe angazhimet dhe se nuk ka në plan ose nuk do të ketë të nevojshme të ndërpresë aktivitetin e saj në një të ardhme të afërt.

3. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël

(a) Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Pasqyrat financiare të Institutit janë prezantuar në Lekë shqiptar (Lekë), e cila është monedha funksionale e Institutit. Informacioni financiar është paraqitur në Lekë.

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021
(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

3. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

Parimet kontabël kryesore të përdorura për përgatitjen e pasqyrave financiare janë si më poshtë:

(b) Njohja e burimeve dhe përdorimit të fondeve

Burimet financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 janë njohur mbi bazën e parimit të të drejtave të konstatuara, për kuotën fikse vjetore për çdo anëtar dhe për kuotat variabël të llogaritura si përqindje mbi të ardhurat bruto të realizuara nga secili anëtar. Shuma e kuotës fikse është përcaktuar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve të datës 17 dhjetor 2020 (vendimi nr. 146) i cili zbatohet nga 1 janar 2021, vendim i cili e ka ulur kuotën fikse në 60.000 lekë nga 70.000 lekë që ka qenë aplikuar. Përqindjet e kuotës variabël janë përcaktuar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve të datës 29 qeshor 2017 (vendimi nr. 126) i cili zbatohet nga 1 janar 2018. Masa e kuotës variabël është 0,5% e të ardhurave totale për nivelin e të ardhurave totale nga 0-8 mln lekë dhe 0,3% e të ardhurave totale për nivelin e të ardhurave totale mbi 8 mln lekë, të cilat janë respektivisht si më poshtë:

	2021	2020
Kuota fikse	60,000	70,000
Kuota variabël	0.5% dhe 03%	0.5% dhe 03%

Në burimet e Institutit përfshihen edhe të ardhurat nga veprimtari të tjera, siç janë publikimet profesionale, nga kualifikimi i vijueshëm dhe nga anëtarët e rinj. Për secilën kategori të këtyre burimeve të fondeve është paraqitur edhe shuma përkatëse e përdorimeve.

Përdorimet e fondeve të njohura në pasqyrat financiare përfshijnë të gjitha pagesat e bëra gjatë vitit dhe shpenzimet e kryera për vitin por që nuk janë paguar në fund të vitit.

(c) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj regjistrohen me kursin e datës së kryerjes së transaksionit.

Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj janë përkthyer me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë në fund të vitit. Diferencat nga kursi i këmbimit të lindura nga përkthimi njihen në pasqyrën e burimeve dhe përdorimit të fondeve. Kursi i këmbimit për dy monedhat e huaja kryesore me monedhën vendase sipas kursit të Bankës së Shqipërisë më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020, ka qenë respektivisht si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
U.S. Dollar (USD)	106.54	100.84
Euro (Euro)	120.76	123.70

(d) Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë gjendjen në arkë, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në para në banka, të cilat janë për një afat maturimi më pak se një vit.



(e) Llogaritë e arkëtueshme dhe llogaritë e pagueshme

Llogaritë e arkëtueshme dhe llogaritë e pagueshme në fund të vitit janë paraqitur me koston e tyre historike. Instituti ka filluar të përlogarisë vlera të arkëtueshme nga kuotat fikse të anëtarëve duke filluar nga 31 dhjetor 2012.

3. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

(f) Aktivët afatgjatë materiale

Aktivët afatgjatë materiale paraqiten me vlerën e tyre historike minus amortizimin e akumuluar. Politika e llogaritjes së zhvlerësimit ka filluar të aplikohet për herë të parë nga 1 janari 2009. Shtesat e aktiveve afatgjatë regjistrohen në kontabilitet me koston e marrjes ose të blerjes të tyre. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë aktivin në vendin dhe kushtet ekzistuese.

Amortizimi është llogaritur me metodën lineare mbi jetën e dobishme të vlerësuar të aktivit, duke aplikuar normat e mëposhtme të amortizimit (sipas IEKA-s):

Kategoria e aktiveve fikse	Normat e amortizimit	
	2021	2020
Ndërtesa	5%	5%
Mjete transporti	20%	20%
Pajisje zyre	20%	20%
Pajisje kompjuterike	25%	25%

Për vitin 2011, është aplikuar llogaritja e zhvlerësimit për herë të parë për ndërtesat.

(g) Teprica dhe defiqiti i burimeve

Teprica / defiqiti midis burimeve dhe përdorimeve, që krijohet gjatë vitit, pasqyrohet në pasurinë neto të IEKA.

(h) Tatimi mbi fitimin

IEKA është institut jofitimprurës. Si i tillë, Instituti nuk paguan tatim mbi fitimin. Instituti respekton dispozitat e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në lidhje me tatimin mbi të ardhurat personale dhe tatimin në burim.

(i) Kontributet për sigurimet dhe Fondi i pensioneve

Shoqëria paguan kontributet për pensione si dhe për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit e saj, siç është parashikuar në legjislacionin shqiptar. Kontributet, bazuar në pagat, janë paguar në llogari të organizmave kombëtare përgjegjëse për pagesën e pensioneve dhe sigurimeve shëndetësore. Nuk ka asnjë detyrim tjetër në lidhje me fondin për pensione dhe sigurimet shëndetësore.



Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021
(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

4. Mjete monetare

Gjendja e mjeteve monetare më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 është si më poshtë:

	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2021	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2020
Paraja në bankë		
Intesa SanPaolo (Lekë)	11,187,759	9,503,964
Intesa SanPaolo (Euro)	23,331	37,511
Intesa SanPaolo (Usd)		(2,610)
Shuma ekuivalente në lekë	11,211,093	9,538,865
Banka Kombëtare Tregtare (Lekë)	9,807,874	8,157,444
Banka Kombëtare Tregtare (Euro)	196,489	204,986
Banka Kombëtare Tregtare-Provimet (Lekë)	121,520	1,098,881
Shuma ekuivalente në lekë	10,125,882	9,461,311
Raiffeisen Bank (Lekë)	17,705,974	12,666,037
Raiffeisen Bank (Usd)	13,097	18,447
Shuma ekuivalente në lekë	17,719,071	12,684,484
Depozita me afat	43,377,666	43,377,666
Totali në Bankë	82,433,742	75,062,325
Paraja në arkë		
Paraja në Arkë (Lekë)	97,601	111,497
Paraja në Arkë (Lekë)		
Paraja në Arkë (Euro)	38,307	45,964
Paraja në Arkë (Usd)		
Totali në arkë	135,908	157,462
Totali	82,569,621	75,219,787

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021
(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)



4. Mjete monetare (vazhdim)

Mjetet monetare të investuara në depozita, sipas afatit të maturimit, paraqiten si më poshtë:

	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2021	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2020
Depozita me afat 12 muaj		
Banka Kombëtare Tregtare	16.076.780	16.076.780
Intesa SanPaolo	7.500.000	7.500.000
Credins Bank	19.800.886	19.800.886
Totali	43.377,666	43.377,666

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 të ardhurat nga interesi janë 45,000 lekë (31 dhjetor 2020: 295,733 lekë).

5. Llogari te arkëtueshme.

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 janë të detajuara si më poshtë:

Përshkrimi	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2021	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2020
AL kuote fikse pjesore dhe penalitete	5.895.860	4.203.770
AL pasive kuota fikse	1.835.325	1.704.750
Kerkesa te tjera per t'u arketuar	1.678.963	859.193
Provizion per kuotat e papaguara	760.750	-
Detyrime per aktivitete	132.950	132.950
	10,303,848	6,900,663

6. Inventarët

Inventarët janë të përbërë si më poshtë:

	Ushtrimi i mbyllur 31 dhjetor 2021	Ushtrimi i mbyllur 31 dhjetor 2020
Kodi Etikës	910	910
SNA	12,480	12,480
Guida	67,950	67,950
Revista	52,334	52,334
Udhërrëfyesi	89,880	89,880
SNA mbi raportin e auditorit të pavarur	83,640	83,640
Të tjera	47,382	47,382
Totali	354,576	354,576

[Signature]
2022

[Signature]



Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021
(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

7. Të arkëtueshme të tjera (kuota variabël)

Të arkëtueshme të tjera përfaqësojnë të drejtat e Institutit ndaj anëtarëve të tij në lidhje me kuotën variabël. Këto të drejta lindin kur anëtarët e Institutit kanë paguar më pak se misionet e deklaruara.

Llogari të arkëtueshme të tjera më 31 dhjetor 2021 janë 10,107,451 Lekë (31 dhjetor 2020: 8,368,781 Lekë).

Detyrime të tjera përfaqësojnë detyrimet e Institutit ndaj anëtarëve të tij për kuotën variabël. Këto detyrime lindin kur anëtarët e Institutit kanë paguar më shumë se misionet e deklaruara.

Detyrimet për kuotën variable më 31 Dhjetor 2021 janë 545,777 Lekë (31 dhjetor 2020: 477,316 Lekë).

8. Aktive afatgjata materiale

Aktivet afatgjata materiale më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 paraqiten si më poshtë:

	Ndërtesa	Mjete transporti	Mobilje dhe pajisje elektronike	Total
Kosto				
Gjendja më 31 Dhjetor 2020	47,455,444	3,273,550	11,274,667	62,003,661
Shtesa	0	0	0	0
Pakësime	0	0	0	0
Gjendja më 31 Dhjetor 2021	47,455,444	3,273,550	11,274,667	62,003,661
Amortizimi i akumuluar				
Gjendja më 31 dhjetor 2020	15,187,537	3,273,550	10,252,245	28,713,332
Nxjerrje jashtë përdorimit	0	0	0	0
Amortizimi vitit	949,408	0	342,554	1,291,962
Gjendja më 31 dhjetor 2021	16,136,945	3,273,550	10,594,799	30,005,294
AAM Vlera Kontabël Neto				
Gjendja më 31 Dhjetor 2020	32,267,907	0	1,022,422	33,290,329
Gjendja më 31 Dhjetor 2021	31,318,499	0	679,868	31,998,367

Zëri "Ndërtesa" rezulton me vlerë bruto 47,455,444 Lekë më 31 dhjetor 2021. Në vitin 2018 është marrë titulli i pronësisë për zyrat e IEKA nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe ato janë konsideruar si aktive afatgjata materiale të IEKA-s.

[Signature]
2022

[Signature]

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021
(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)



9. Llogari të pagueshme dhe detyrime

Përshkrimi	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2021	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2020
Komiteti i Cilësisë	707,885	707,885
Komiteti i Edukimit		
Komiteti i Kualifikimit të vijshëm	435,000	44,000
Komiteti i Perktimit		
Keshilli i Drejtimit	690,396	120,000
Komiteti i Regjistrimit		
Totali	1,833,281	871,885
Përshkrimi		
EDIL AL-IT punime të zyrave të reja	178,494	178,494
Detyrime ndaj punonjesve	49,989	
Geci shpk		
Te tjera	5,395,960	1,535,601
Alb Paper		
Vitrina Franceze		
APA-Albpartner		149,400
Detyrime ndaj të tregëve	1,135,745	650,650
Avokati		
Detyrim për tarifen 7% për BMP	1,705,215	2,237,571
Totali	8,465,403	4,751,716
Totali i llogarive të pagueshme	10,298,684	5,623,601

Qeshin
2022

Qeshin

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021
(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

10. Detyrime tatimore

Përshkrimi	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2021	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2020
Shteti tatime taksa (TAP)	713,063	253,514
Sigurime shoqërore	108,297	104,802
	<u>821,360</u>	<u>358,316</u>

11. Të ardhura dhe shpenzime të periudhave të ardhëshme

IFAC, IEKA dhe SHKÇAK kanë lidhur një marrëveshje trepalëshe me qëllim uljen e kostove të përkthimit si dhe në kuadër të unifikimit të terminologjisë profesionale me fushëveprim përkthimet e dokumentave të Bordeve të IFAC siç janë Guidat. Kodet e Etikës dhe dokumenta e propozime të tjera të publikuara nga IFAC. Në të ardhura të periudhave të ardhëshme janë grupuar edhe disa pagesa të kuotave të kryera më tepër (kuota fikse të AL, kuota të kandidatëve, të kandidatëve për provime AL/KM etj.) që të konsiderohen për vitin në vijim në shumën 526,070 Lekë.

12. Ndryshime në pasurinë neto

Gjatë vitit 2021 pasuria neto e IEKA-s është rritur me shumën 6,053,139 Lekë.

13. Burimet e fondeve nga veprimtaria kryesore

Burimet e fondeve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 janë të përbëra si më poshtë:

Përshkrimi	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2021	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2020
Nga kuota fikse Alve	14,365,000	16,062,867
Nga kuota variabël e Alve	8,762,712	8,286,119
Nga kuota e regjistrimit në praktiken prof.	1,275,000	2,550,000
Nga kuota e regjistrimit të shoqërive	235,000	245,000
Nga kuota fikse ALve Pasive	1,232,500	606,959
Të ardhura të tjera Sponsorizime - Konferenca 20 Vjetori	894,610	878,938
Totali i Të Ardhurave	<u>26,764,822</u>	<u>28,629,883</u>

Po më 2022 për ekste
bëre 25 yetai IEKAS
6 22141

2022

11



13. Burimet e fondeve nga veprimtaria kryesore (vazhdim)

Në Janar të vitit 2015, me hyrjen në fuqi të ndryshimit të Statuti të IEKA për afatin e deklarimit të misioneve të AL dhe Shoqërive (nga 31 mars u vendos në 25 janar) u regjistruan në të ardhurat nga kuotat variable edhe të ardhurat sipas deklarimit të misioneve për vitin 2014.

Të ardhurat nga kuota variable përfaqësojnë të ardhurat sipas deklarimit të misioneve të AL-ve për vitin 2021/2020.

Të drejtat për kuotat e AL pasive të arkëtushme (të pambledhura deri më 31 dhjetor 2020) nuk janë njohur në të ardhura meqënëse Drejtimi i Insitutit vlerëson si mjaft të vështirë mbledhjen e tyre.

Per vitin 2021 referuar regjistrin publik të anëtarësisë së AL, për AL-të me statusin pasiv është reflektuar në të ardhura kuota e pasiveve e arkëtueshme. Ndërsa për koutat e pambledhura deri me 31 dhjetor 2020, do të raportohen në rezultatin e vitit 2022, pasi të analizohet statusi i tyre dhe të merret vendimi përkatës.

14. Përdorimet e fondeve për veprimtarinë kryesore

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2021	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2020
Përdorimet e fondeve për veprimtarinë kryesore		
Pagat e punonjësve	5.103,201	6.172.658
Sigurimet shoqërore	750.715	868.920
Te tjera		-
Nen Totali - Pagat e punonjesve dhe sigurimet shoqerore	5,853,916	7,041,578
 Honorare drejtimi, KKB, Audituesi i PF	4.834.000	4.385.000
Honorare për Autoritetin e Regj. dhe komitete	450.000	894.500
Nen Totali - Drejtimi, Honoraret e Komiteteve	5,284,000	5,279,500
 Shpenzime zhvleresimi	1.291.962	1.446.138
Kuota regjistrimi në org. Profesionale	1.736.000	1.524.090
Udhëtime e djeta		219.992
Telefon, internet	365.672	267.502
Energji, ujë	328.625	255.978
Kancelari	85.725	158.637
Shpenzime për konsulencë ligjore		1.675.632
Shpenzime për investime		599.862



Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021
(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

Shpenzime te tjera	4,615,658	1,471,931
Shpenzime për tarifen 7% për BMP	1,705,215	2,237,571
Nen Totali - Shpenzime administrative dhe te tjera	10,128,856	9,857,333
Totali përdorimeve	21,266,772	22,178,411

Më 31 dhjetor 2021 Instituti ka 5 punonjës me kohë të plotë (31 dhjetor 2020: 5 punonës me kohë të plotë).

Diferenca midis Burimeve nga veprimtaria kryesore (Shënimi 13) dhe Përdorimeve nga veprimtaria kryesore (Shënimi 14) është në shumën prej 5,498,050 lekë (2020: 6,451,472 Lekë).

15. Burimet dhe përdorimet e fondeve për kualifikimin e AL-ve dhe kandidatëve

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2021	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2020
Burimet e fondeve nga kualifikimi AI	570,000	410,000
Burimet e fondeve nga kandidatët	2,196,000	2,910,000
Burimet nga trajnimi SKK/SNK		
Totali	2,766,000	3,320,000
Përdorimet e fondeve për kualifikimin e AI	(509,853)	(542,580)
Përdorimet e fondeve për kualifikimin e kandidatëve	(1,740,052)	(2,453,866)
Përdorimet nga trajnimi SKK/SNK		-
Totali	(2,249,905)	(2,996,446)
Teprica nga kualifikimet për AL dhe kandidatët	516,095	323,554



16. Burime dhe përdorime nga botimet

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2021	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2020
Totali i të ardhurave nga botimet		3,400
Totali i shpenzimeve të botimeve		(82,877)
Teprica nga Botimet	-	(79,477)

17. Teprica/(deficit) neto i burimeve të vitit

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2021	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2020
Teprica e Burimeve		
Teprica nga aktiviteti	5,498,050	6,451,472
Teprica nga kualifikimet	516,095 -	323,554
Teprica nga Botimet	- -	(79,477)
Aktivitetet prof që mbulohet nga tep. Akumuluar	- -	-
Te ardhura financiare	38,994	300,843
Teprica	6,053,139	6,996,392

18. Ngjarje pas datës së raportimit

1. Pas datës 31 dhjetor 2021 është evidentuar një gabim në raportimin e pasqyrave financiare për periudhën e raportimit 2020. Gabimi është vlerësuar si material në shumën 290,825 lekë Shënimi 17: (Teprica/deficit i burimeve nga veprimtaria kryesore). Bazuar në SKK nr. 1 Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, paragrafi nr. 112: dhe dhe SKK nr. 2 Paraqitja e Pasqyrave Financiare, paragrafi nr. 51, është korrigjuar zëri i raportimit, "Kërkesa të tjera për t'u arkëtuar", në rritje për shumën 290,825 lekë dhe "Të ardhura të tjera" në rritje për shumën 290,825 lekë.

2. Më datë 18.07.2022, në vijim të procesit të auditimit të Pasqyrave Financiare për Vitin Ushtrimor 2021, u konstatua një gabim në deklarimin e pagave për vlerën 70,805 lekë. Gabimi është vlerësuar si material. Bazuar në SKK nr. 1 Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, paragrafi nr. 112: dhe dhe SKK nr. 2 Paraqitja e Pasqyrave Financiare, paragrafi nr. 51, janë rishikuar zërat e raportimit, duke ulur koston e personelit në shumën 70,805 lekë dhe detyrimet tatimore në shumën 70,805 lekë.

Q. K. K.
2022

Q. K. K.

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021
(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

3. Me Vendimin Nr. 48 dt.09.11.2021 të Këshillit të Drejtimit është ngritur Grupi i Punës për Financën i cili në kuadër të sigurimit të funksionimit të rregullt të Institutit, i është kërkuar të bëjë propozimet përkatëse në lidhje me ceshtjet e evindetuara. Drejtori Ekzekutiv ka ngritur Komisionin i Inventarizimit të Aseteve për vitin 2021, i cili ka hartuar edhe Procesverbalin përkatës.

Nisur nga evidencat e procesit të inventarizimit të asetëve, është kontaktuar që regjistrat kontabël krahasuar me gjendjen fizike nuk ofrojnë sigurinë dhe besueshmërinë e duhur të informacionit.

Në procesin e verifikimit paraprak të regjistrat të asetëve materiale, materialeve didaktike të institucionit, inventarëve të publikimeve, konstatohet mungesa e kodifikimit të tyre. Mungesa e kodifikimit e bën të vështirë identifikimin e gjendjes reale të asetëve dhe inventareve krahasuar me gjendjen kontabël. Kodifikimi dhe inventarizimi në bazë të tij rrit sigurinë dhe besueshmërinë e informacionit të raportuar.

Bazuar në sa më sipër rekomandohet të ngrihet një grup pune, i cili duhet të hartojë një rregullore për manaxhimin e asetëve si dhe të kryjë inventarizimin e të gjitha asetëve materiale, materialeve didaktike të institucionit, inventarëve të publikimeve, duke përcaktuar edhe kodifikimin tyre, si dhe dokumentim me foto të cdo asemi të inventarizuar. Rezultatet e këtij inventari do të behen pjesë integrale e raportimit të Pasqyrave Financiare të vitit 2022.

4. Shifrat e vitit ushtrimor 2021 janë të krahasueshme me vitin ushtrimor 2020, për arsye se janë bazuar në (S.K.K), dhe nuk ka pasur ndryshime në politikat kontabile nga organizata. Pas datës 31.12.2021 nuk ka pasur ngjarje materiale të cilat mund të ndikojnë në vazhdimësinë e aktivitetit të organizatës.

IEKA është angazhuar në ndjekjen e disa rasteve të padive të ngritura prej saj si palë paditëse dhe të disa rasteve si palë e paditur, objekti i të cilave ka të bëjë me aktivitetin operacional të organizatës. Nuk ka siguri për vlerësimin e vlerës së proceseve të ngritura. Proceset e ngritura nuk kanë ndikuar dhe nuk do të ndikojnë në vijimësinë e aktivitetit.

Silda Metani

Arminda Qylafku

Sektori i Finances

Drejtor Ekzekutiv

Silda Metani
Profesor
2022

Arminda Qylafku
Profesor